

Shërbimet e ndërhyrjes në fëmijërinë e hershme për fëmijët e moshës 0-6 vjeç

Projekti për mbështetjen e fëmijëve me ngecje në zhvillim dhe aftësi të kufizuara



ÇFARË ËSHTË NDËRHYRJA NË FËMIJËRINË E HERSHME?

Ndërhyrja në fëmijërinë e hershme (NFH) mbështet zhvillimin e fëmijëve të vegjël (nga lindja deri në moshën 6 vjeç) të cilët kanë ngecje në zhvillim apo aftësi të kufizuara.



NFH fokusohet në ndihmën e fëmijëve për të fituar aftësi që zakonisht zhvillohen gjatë viteve të hershme të jetës, të tilla si:

- Fizike/motorike: rrotullimi, zvarritja dhe ecja
- Kognitive: të menduarit, të mësuarit, zgjidhja e problemeve
- Komunikimi: të folurit, të dëgjuarit, të kuptuarit
- Sociale/Emocionale: loja, të ndjerit i sigurt dhe i lumtur
- Vetë-ndihma: të ushqyerit, veshja, tualeti

PSE FOKUSOHEMI NË VITET E PARA?

Vitet e hershme formojnë bazën për një zhvillim të shëndetshëm dhe të gjithëmbarshëm të fëmijës. Përvojat e hershme formësojnë mënyrën se si zhvillohet truri i fëmijës, duke krijuar bazën për të gjithë mësimin, sjelljen dhe shëndetin në të ardhmën.

Vitet e fëmijërisë së hershme janë veçanërisht të rëndësishme për fëmijët me ngecje në zhvillim ose paaftësi.

Sigurimi i mbështetjes adekuate gjatë kësaj periudhe kritike mund të përmirësojë zhvillimin e fëmijëve, të përmirësojë pjesëmarrjen dhe përfshirjen dhe të rrisë cilësinë e përgjithshme të jetës së tyre.

Sa më herët që një fëmijë të marrë ndërhyrje, aq më i madh është potenciali për rezultate pozitive zhvillimore.

SI OFROHEN SHËRBBIMET E NDËRHYRJES NË FËMIJËRINË E HERSHME?

Ndërhyrja në fëmijërinë e hershme përfshin një shumëllojshmëri të gjerë të ofruesve të shërbimeve, duke përfshirë:

- Logopedë
- Ergoterapeutë
- Fizioterapeutë
- Psikologë
- Edukatorë

Këta profesionistë bashkëpunojnë për të siguruar që të gjitha fushat e zhvillimit të fëmijës të mbështeten gjatë kohëzgjatjes së projektit.

NFH ka në qendër familjen, me familjet që luajnë një rol kyç në mbështetjen e zhvillimit të fëmijës së tyre. Prindërit dhe kujdestarët janë të përfshirë në identifikimin e rezultateve, pjesëmarrjen në ndërhyrje dhe strategjitë e të mësuarit për të ndihmuar fëmijën e tyre të mësojë në aktivitetet e përditshme.

SI PËRCAKTOHET PËRSHTATSHMËRIA PËR SHËRBBIME?

HANDIKOS Ferizaj ka krijuar ekipe multidisiplinare për të ofruar shërbime të NFH-së për fëmijët e moshës 0-6 vjeç.

Fëmijët të cilët janë të kualifikuar për këto shërbime përfshijnë:

- Fëmijët me një gjendje fizike ose mendore të diagnostikuar e cila ka probabilitet të lartë të vonesës në zhvillim.
- Fëmijët me një vonesë zhvillimi prej të paktën 25% në një ose më shumë fusha zhvillimi:

Gjuhë/Zhvillim Kognitiv

Zhvillimi Social/Emocional

Zhvillimi fizik

Vetëndihma

KUSH MUND T'I REFEROJË FËMIJËT PËR SHËRBBIMET ECI?

Referimet mund të bëhen nga çdo individ ose institucion, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- Prindërit
- Anëtarët e familjes
- Pediatrit/Mjekët Familjarë
- Infermieret e vizitave në shtëpi
- Institucionet parashkollore
- Spitalet
- Shërbimet sociale

ÇFARË NDODH PAS REFERIMIT?

Pasi të pranohet referimi, ekipi i NFH-së kontakton familjen për të filluar një vlerësim për të përcaktuar përshtatshmërinë e fëmijës për shërbime bazuar në kriteret e sipërpërmendura. Nëse kualifikohet, ekipi kryen vlerësime të mëtejshme, zhvillon një Plan të Individualizuar të Shërbimit Familjar (PIShF) dhe fillon ofrimin e shërbimeve.

SI MUND TË KONTAKTOJ EKIPET E NFH-SË?

Për të referuar një fëmijë për shërbimet e NFH-së, ju lutemi kontaktoni zyret e HANDIKOS Ferizaj duke përdorur informacionin e mëposhtëm:

Adresa: Rr . Zenun Beqa, Objekti Fitorja 1 Ferizaj, Kosovë.
Numri i telefonit: +383 49 945 102
Email adresa: handikosferizaj@gmail.com
Faqja e internetit: handikosferizaj.org



Mbështetja e fëmijëve me ngecje në zhvillim dhe aftësi të kufizuara në arritjen e potencialit të tyre

